



COVID-19


Pastrimi dhe dezinfektimi i mjediseve shkollore

Në janar 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) deklaroi shpërthimin e sëmundjes së re të COVID-19 emergjencë të shëndetit publik me shqetësim ndërkombëtar.

COVID -19 është sëmundje e shkaktuar nga koronavirusi (SARS-COV2), fillimisht i zbuluar në dhjetor të vitit 2019.

Koronavirusi (COVID-19) përhapet përmes:


- Spërklave të pështymës gjatë kollitjes apo tështimës
- Kontaktit të afërt personal si prekja, përqafimi, dhënia e dorës
- Përmes kontaktit me sipërfaqe dhe gjësende të kontaminuara.



Personi i infektuar me SARS-COV2 i ka këto shenja:

- lodhje
- ethe
- temperaturë
- kollë
- dhimbje të shpinës
- dhimbje të kokës,
- humbje të shijës dhe
- vështirësi në frymëmarrje.

**NGA VIRUSI (SARS-COV2)
MUND TË INFEKTOHET
ÇDO NJËRI!**




Masat parandaluese të përgjithshme

Masat parandaluese duhet të ndërmerren nga gjithë stafi i shkollës dhe nxënësit, me qëllim të parandalimit të përhapjes së mundshme të COVID-19.

Këto masa përfshijnë:

- **Larjen e rregullt të duarve** me sapun dhe ujë të rrjedhshëm ose dezinfektimin e duarve me preparate dezinfektuese me bazë alkooli 70%, si dhe shmangja e prekjes së syve, hundës dhe gojës, veçanërisht kur duart nuk janë të pastra
- **Vendosjen e maskës duke mbuluar gojën dhe hundën.** Gjatë kollitjes ose teshtitjes duhet ta mbuloni gojën dhe hundën me anën e brendshme të bërrylave ose të përdorni faculetë të cilën pastaj e hudhni në shportë mbeturinash me kapak
- **Respektimin e distancës fizike** së paku 1.5 metra aty ku është e mundur si dhe të kufizohet numri i nxënësve në hapësira të mbyllura.



Mësimdhënësit dhe nxënësit me shenja: temperaturë, frymëmarrje të vështërsuar ose ethe duhet të qëndrojnë në shtëpi / të izoloohen dhe të kërkojnë këshilla mjekësore.

Nëse një punonjës i shkollës ose një nxënës dyshohet se është infektuar ose është konfirmuar me COVID-19, duhet të gjithë hapësirat - zonat që ata kanë përdorur ose vizituar të pastrohen dhe dezinfektohen.

Principet e pastrimit dhe dezinfektimit të mjedisit

Veprimet për ti mbajtur nxënësit të sigurt në shkolla janë veprime thelbësore. Tani, më shumë se kurrë, fëmijët kanë nevojë për mjedise të sigurta, të pastra dhe të këndshme për mësim dhe aktivitete tjera.

Pastrimi i sipërfaqeve të dukshme në mjediset shkollore dhe dezinfektimi i tyre është njëra nga praktikat më të mira për të ndaluar përhapjen e koronavirusit.

Pastrimi dhe dezinfektimi i mjedisit duhet të bëhet në mënyrë korrekte dhe të vazhdueshme.

- **Pastrimi** me ujë dhe mjete higjienike, shpërlarja dhe tharja është metoda më e mirë për largimin e mikroorganizmave nga sipërfaqet që preken shpesh nga nxënësit, si: tavolinat, bankat, karrigat, dorëzat e dyerve dhe dritareve, ndërprerësit e dritave, parmakët e shkallëve, rubinetat dhe lavamanët në tualet.
- Pastrimi mekanik i sipërfaqeve zvogëlon fizikisht numrin e mikrobeve në sipërfaqe. Shpërlarja me ujë të pastër dhe detergjent largon mikrobet, kurse tharja e sipërfaqeve e bën më të vështirë mbijetesën ose rritjen e mikrobeve.



- Viruset, duke përfshirë edhe virusin që shkakton COVID-19, janë të ndjeshëm ndaj mjeteve higjienike si sapunave/detergjenteve dhe dezinficientëve
- Dritaret duhet të mbahen të hapura derisa të pastrohen klasat dhe korridoret. Klasat duhet të ajrosen 5-6 herë gjatë gjithë orarit të mësimit - pas çdo ore mësimore nga 5 min. Ambientet tjera të shkollës si korridoret, laboratorët, sallat sportive, poashtu duhet të pastrohen dhe ajrosen sikur klasat
- Korridoret duhet pastrohen pas pushimeve të gjata - çdo dy orë
- Tualetet duhet pastrohen dhe dezinfektohen çdo 30 minuta.



**Fillimisht të gjitha
sipërfaqet duhet të
pastrohen më pas të
dezinfektohen.**

- **Dezinfektimi** ose përdorimi i kimikateve ka për qëllim të kufizojë mbijetesën e mikrobeve duke i shkatërruar ato nga sipërfaqet dhe në këtë mënyrë të parandalojë transmetimin e sëmundjes.

**Dezinfektuesit nuk janë zëvendësues të pastrimit.
Të gjitha sipërfaqet duhet të pastrohen së pari me ujë
dhe sapun/detergjent dhe pastaj te dezinfektohen.**

- Duhet të kemi kujdes, që mos të spërkatim dezinfektues direkt në sipërfaqe. Vendosni dezinfektuesin në pëlhurë, peshqir apo letra të pastërta dhe pastroni/dekontaminoni sipërfaqet. Përdorni pëlhura/peshqirë ose letra për një përdorim. Përndryshe, sigurohuni që pëlkurat të pastrohen dhe thahen pas përdorimit për të minimizuar rrezikun.



- Filloni nga zonat më të pastra dhe vazhdoni në vendet më të ndyra për të shmangur përhapjen e papastërtive dhe mikrobeve.
- Përdorni solucione pre dezinfektim sipas udhëzimeve të prodhuesve.
- Stafi i mirëmbajtjes së shkollës gjatë dezinfektimit duhet të përdorin pajisje mbrojtëse, si: maska, dorëza për pastrim, përparëse plastike, syza për mbrojtjen e syve nga kemikaljet si dhe këpucë të mbyllura.

DUHET PATUR KUJDES QË:

Dezinfektimi i klasëve duhet të realizohet kur nxënësit nuk janë prezent në klasë, meqë ekspozimi në lëndë të tilla mund të shkaktojë probleme në shëndetin e tyre.

Solucionet e rekomanduara dezinfektuese

Për pastrimin e mjedisit me raste të dyshuara ose të konfirmuara me COVID-19, përdorni dezinfektues që janë aktivë kundër virusit.

Rekomandimet e OBSH-së përfshijnë:

- **Hipoklorit natriumi (zbardhues)** për dezinfektimin e sipërfaqeve dhe
- **70% tretësirë që përmban alkohol/etanol** për dezinfektimin e sendeve të vogla ose sendeve që nuk e tolerojnë zbardhuesin.

Gjithmonë ndiqni udhëzimet e prodhuesit për hollimin dhe përdorimin e prepareve dezinfektuese.



- Zbardhuesi i holluar duhet të përdoret brenda 24 orëve nga përgatitja, pasi ndikimi i tij mund të zvogëlohet me kalimin e kohë
- Dezinfektuesi duhet të përgatitet dhe të ruhet në një enë të pastër dhe të tharë.

Largimi i mbeturinave

Trajtoni të gjitha mbeturinat me kujdes. Personeli duhet të përdorë të njëjtat masa paraprake për mbrojtje sikur gjatë pastrimit dhe dezinfektimit:

- Siguroni që shkolla të ketë qese/thasë të mjaftueshëm për mbeturina
- Trajtoni të gjitha mbeturinat me kujdes
- Siguroni mbeturinat në një thes të cilin pastaj e mbyllni mirë dhe e hidhni në vende të caktuara, mundësisht larg objektit shkollor
- Hudhni solucione pastruese në thasë/qese sipas udhëzimeve përkatëse nëse ka nevojë.



Përkrahur nga OBSH, Zyra në Prishtinë,
përmes fondeve të Ambasadës Britaneze,
përmes instrumentit MPTF - Fondit të
Partneritetit Shumëpalësh!